KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 40/2026
Hagë, 05/11/2026

Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, Trupi Gjykues urdhëroi muajin e kaluar që të bëheshin publike versionet me më pak redaktime të transkripteve të dëshmive të 29 dëshmitarëve. Kjo ishte në vijim të vendimeve të mëparshme në bazë të të cilëve u bënë publike dëshmitë e 20 dëshmitarëve që më parë ishin konfidenciale.

Këto vendime pasqyrojnë natyrën publike të proceseve gjyqësore dhe angazhimin e gjykatësve për transparencë. Gjatë gjykimit për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, shumica e dëshmitarëve dhanë dëshmi tërësisht ose kryesisht në seanca publike dhe 61 dëshmitarë dhanë dëshmi pa masa mbrojtëse. Dëshmitë e dëshmitarëve që fillimisht ishin konfidenciale rishikohen vazhdimisht në mënyrë që sa më shumë dëshmi të bëhen publike më pas, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen në vijimësi të viktimave dhe dëshmitarëve. Transkriptet dhe videot e seancave publike mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-së, ku janë të organizuara sipas datës së seancës, ose në kanalin e Gjykatës në *YouTube*.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 16 shtator, palëve iu dorëzua versioni i plotë konfidencial i Aktgjykimit, përfshirë z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi, z. Krasniqi dhe ekipeve të tyre mbrojtëse.

Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të plotë është duke u përgatitur me shpejtësi, për siguruar që sa më shumë informacion që është e mundur të bëhet publik, por duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

Volumi i Aktgjykimit dhe hapat proceduralë përkatës mund të kenë ndikim në kohën e publikimit. Pasi u lëshua Aktgjykimi, Trupi Gjykues urdhëroi Prokurorinë, ekipet e Mbrojtjes dhe Mbrojtjen e Viktimave të paraqesin komentet lidhur me redaktimet e mundshme brenda afatit të caktuar nga Trupi Gjykues. Mbi këtë bazë, po përgatitet dhe do të lëshohet nga Trupi Gjykues një version i redaktuar publik. Versioni i plotë i redaktuar publik i Aktgjykimit do të lëshohet sa më shpejt që të jetë e mundshme.

Si kujtesë: afati i ekipeve të Mbrojtjes për të dorëzuar njoftimet për apel është 27 nëntori 2026. Sipas Ligjit dhe Rregullores, Aktgjykimi dhe dënimi mund të apelohen mbi bazën e një gabimi të pretenduar faktik ose juridik. Paneli i apelit përbëhet nga gjykatës të tjerë, të cilët, në mënyrë të pavarur, shqyrtojnë arsyet e apelit të paraqitura prej palëve. Paneli i apelit mund të konfirmojë, të prapësojë, ose të rishikojë Aktgjykimin e Trupit Gjykues.

Në çështjen gjyqësore Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, ka përfunduar afati për regjistrimin paraprak për të marrë pjesë në seancën për shqiptimin e Aktgjykimit më 17 nëntor në ndërtesën e DHSK-së dhe ka filluar procesi i dërgimit të mesazheve

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. *Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në* https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine

elektronike personave që kanë bërë kërkesë për ta ndjekur seancën nga galeria për publikun. Kërkojmë mirëkuptimin e atyre që nuk morën konfirmim për të qenë në ndërtesë atë ditë, pasi interesi për të ndjekur seancën ka qenë i lartë, hapësira e kufizuar dhe ishte e nevojshme t'u jepej përparësi anëtarëve të familjes së ngushtë të të akuzuarve. Shqiptimi i Aktgjykimit mund të ndiqet kudo nëpër botë, me një vonesë të shkurtër prej 10 minutash, në faqen e internetit të DHSK-së, në shqipe, anglishte ose serbishte. Incizimi i seancës do të vendoset edhe në kanalin *YouTube*.

Sipas Aktakuzës, të paktën mes 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të ndryshme jo të privilegjuara në objektin e paraburgimit, Hashim Thaçi u dha Bashkim Smakajt, Isni Kilajt dhe Fadil Fazliut informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të Prokurorisë dhe, së bashku me ta, si dhe me persona të tjerë për të cilët nuk janë ngritur akuza, u përpoq të ndikonte në dëshmitë e disa dëshmitarëve. Në Aktakuzë pretendohet gjithashtu se z. Thaçi ra në marrëveshje me z. Kuçi që ky i fundit të kontaktonte dëshmitarë të Prokurorisë në çështjen gjyqësore për krime lufte Thaçi dhe të tjerët, në kundërshtim me urdhrin që ua ndalonte këtë përveç nëse ishin në përputhje me procedura të caktuara.

Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore u vetëdeklaruan të pafajshëm lidhur me të gjitha akuzat. Isni Kilaj u lirua me kusht në dhjetor të vitit të shkuar, ndërsa Bashkim Smakaj dhe Fadil Fazliu u liruan me kusht në shkurt 2026.

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. *Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në* https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine